



**ARGUMENTIMI  
JURIDIK-KUSHTETUES I PAVARËSISË SË  
KOSOVËS DHE VENDIMI I GJND-së**

**Prof. dr. Arsim Bajrami, anëtar korrespondent**

# Hipotezat e ligjëratis

1. Rasti i Kosovës paraqet rast tipik të vetëvendosjes dhe në esencë është një zgjidhje kushtetuese e së drejtës së një kombi për të qenë i lirë dhe i pavarur.
2. Me njohjen e pavarësisë së Kosovës, Bashkësia ndërkombëtare po rivendosë drejtësinë e mohuar, duke përmirësuar gabimet një shekullore përkatësisht të drejtën e një populli autokton për të qenë i mvetësishëm dhe për të vendosur për fatin e tij.
3. Pavarësia e Kosovës, është në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtën e kombeve në vetëvendosje, e konfirmuar edhe me Vendimin e GJND-së.

# Aspekti historik i copëtimit të trojeve shqiptare

- Vilajeti i Kosovës;
- Kongresi i Berlinit;
- Konferenca e Londrës, 1878;
- Lufta e parë botërore, 1913;
- Konferenca e Versajit, 1919;
- Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene;
- Lufta e Dytë Botërore;

# Aneksimi i dhunshëm i Kosovës brenda Federatës Jugosllave

- Karta e atlantikut shpresë për vetëvendosje për fatin e popujve;
- Rezoluta e Bujanit dhe e drejta vetëvendosjes-kahja gjeopolitike e bashkimit kombëtar;
- Vendosja e Administrimit ushtarak në Kosovë dhe përgatitja e Aneksimit të dhunshëm;
- Kuvendi i Prizrenit dhe aneksimi i dhunshëm i Kosovës nga Serbia;
- Jo legjitimiteti i vendimit të Kuvendit të Prizrenit;
- Kosova asnjëherë nuk ishte pjesë e Serbisë, por rast tipik të aneksimit dhe amputimit kushtetues nga Serbia;
- “Vendimi i Kuvendit të Serbisë edhe pse i dhunshëm dhe jo legjitim në mënyrë të tërthortë i referohet parimit të vetëvendosjes” - Akademik Gazmend Zajmi;
- Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut 1990 riaktivizonte të drejtën e vetëvendosjes me referimin të klauzola "rebus sic stantibus".



# Autonomia e Kosovës në kuadrin e Federatës Jugosllave

- Baticat dhe zbaticat e autonomisë së Kosovës brenda Federatës Jugosllave;
- Rilindja e autonomisë në vitin 1969;
- Autonomia politiko-territoriale sipas Kushtetutës së vitit 1974;
- Subjektiviteti politiko-kushtetues i Kosovës sipas Kushtetutës së vitit 1974;
- Karakteri konstitutiv i Kosovës në Federatën Jugosllave;
- Rrënimi kundër kushtetues i autonomisë së Kosovës në vitin 1989.

# Lindja e Republikës së Kosovës

- Kriza e socializmit si proces, lindja e demokracisë dhe pluralizmit politik në Evropën Juglindore;
- Shkatërrimi Ish-Jugosllavisë dhe ekspansionizmi serb në krimin e Serbisë së Madhe;
- Deklaratë Kushtetuese e 2 Korrikut 1990;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 7 shtator 1990;
- Referendumi për pavarësinë e Kosovës, tetor 1991;
- Organizimi i jetës në kushtet e okupimit;
- Paraqitja e UÇK-së dhe transformimi i çështjes së Kosovës nga sfondi i shkeljes së lirive dhe të drejtave të njeriut në çështje statusore, konstitucionale dhe territoriale;
- Lufta çlirimtare dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës;
- Konferenca e Rambujesë dhe partneriteti strategjik politiko ushtarak në mes të Kosovës, SHBA-së dhe BE-së;
- Bombardimet e NATO-s dhe debatet legale pro dhe contra intervenimit;
- Bombardimet e NATO-s dhe promovimi i doktrinës së sovranitetit të kufizuar.

# Çlirimi i Kosovës dhe administrimi ndërkombëtar-Rezultati

- Rezoluta 1224 dilemat dhe kontraversat;
- Korniza Kushtetuese;
- Ndërtimi i institucioneve demokratike në Kosovë;
- UNMIK-u ngecjet dhe lajthitjet;
- Konceptimi i gabuar i sovranitetit nga UNMIK-u;
- Procesi i Vjenës dhe Pakoja e Ahtisarit.

# Ndërtimi i konsensusit ndërkombëtar rreth pavarësisë së Kosovës

- Shpallja e koordinuar e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës;
- Deklarata e Pavarësisë dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës akte të shtet formimit;
- Ndërtimi i kapaciteteve shtetërore në Kosovë-legjislacioni dhe institucionet shtetërore;
- Përfundimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, 10 shtator 2012.



# Kontestim i aktit të shpalljes së pavarësisë tek Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë- Argumentet kundër pavarësisë së Kosovës

- Serbia, “akti i pavarësisë akt seccionist”
- Rusia - “Kosova sipas të drejtës ndërkombëtare është nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dhe as shqiptarët e as Beogradi nuk mund të ndër marrin hapa unilateral që ta sfidojnë UNMIK-un”.

# Deklarata e Spanjës dhe e Qipros

- “Spanja konsideron se Rezoluta 1244 ende është në fuqi dhe procesi i gjetjes së një zgjidhje ende në vazhdim e sipër, gjithnjë derisa Këshilli i Sigurimit nuk merr ndonjë vendim tjetër, sipas saj çështja e Kosovës është zgjidhur me vendimin e Këshillit të Sigurimit.”
- “Sipas Qipros, Kosova ishte një etnitet i caktuar si “pakicë” dhe e drejta për vetëvendosje i takonte vetëm popujve dhe jo pakicave të caktuara”.

# Deklarata e Shqipërisë dhe SHBA-së

- “Shqipëria Konsideronte se Kosova është një rast tipik i vetëvendosjes së popujve”;
- SHBA -“Deklarata e pavarësisë së Kosovës kontribut i tre proceseve të ndërlidhura: Shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, krizës së lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovës dhe përgjigjjes së Kombeve të Bashkuara”.

# Deklarata e Kroacisë

- Kroacia - “Pavarësia e Kosovës ishte rrjedhojë e kontinuitetit të ngjarjeve si: Pozita kushtetuese brenda Jugosllavisë, heqja e paligjshme e autonomisë, shkeljet e rënda të lirive dhe të drejtave të njeriut, dështimi i përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për të gjetur zgjidhje të negociuar në mes të Beogradit dhe Prishtinës”.

# Deklarata e Gjermanisë

- Gjermania - “Parimi i vetëvendosjes është i pranueshëm si zgjedhja e fundit dhe e vetmja, për shkak të diskriminimit dhe shkeljeve masive të lirive dhe të drejtave të njeriut. Kosova përmbush kushtet për të qenë e pavarur sepse ka popullatën, territorin dhe popullsinë e vet”.

# Deklarata e Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar

- Franca - “Shpallja e pavarësisë së Kosovës, e miratuar zyrtarisht me 17 shkurt 2008, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, sjell përfundimin e një procesi që kishte origjinën nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë.
- Mbretëria e Bashkuar - “Serbia nuk bën të fokusohet vetëm në ditën e shpalljes së pavarësisë, por edhe në zhvillimet që i kanë paraprirë asaj. Serbia në GJND po tenton ta kthejë orën prapa, por tanimë ajo nuk mund të kthehet”.

# Parimet dhe shtyllat e Vendimit të GJND-së

- Legjitimiteti i shpalljes së pavarësisë nga përfaqësuesit e zgjedhur të popullit;
- Pavarësia e Kosovës rrjedhë logjike e shkatërrimit të Jugosllavisë dhe vetëvendosjes së popujve;
- E drejta e vetëvendosjes sipas GJND-së, bazohet në parimin *jus cogens* të aplikuar në rastin e Timorit lindor dhe që ka zbatim jo vetëm në rastet dekoloniale, por paraqet një të drejtë universale të popujve në vetëvendosje;
- Pavarësia e Kosovës nuk është akt seccionist - por rast i koordinimit ndërkombëtarë për zgjidhjen e konfliktit territorial mes Serbisë dhe Kosovës;
- Pavarësia e Kosovës veprim logjik zinxhiror në relacionin Rambuje, Rezoluta 1244, Korniza Kushtetuese 2001, Pakoja e Ahtisarit deri te Deklarata e Pavarësisë;
- Shkatërrimi i Jugosllavisë e nxjerr Kosovën si një nga suksesorët e barabartë me të drejtën e vetëvendosjes;
- Pavarësia e Kosovës storie e suksesit ndërkombëtar;
- Pavarësia e Kosovës rast *sui generis* dhe i pa përseritshëm.

# Shpallja e pavarësisë së Kosovës përballë konventës së Montevideos-1933

- Konventa mbi te drejtat dhe detyrat e shteteve (Montevideo-1933) përcakton se shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare duhet të ketë:
  - Popullsinë e përhershme;
  - Territorin e caktuar;
  - Qeverinë;
  - Aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera.



# Konkluzionet

- Kosova rast tipik i vetëvendosjes së një populli autokton dhe liridashës;
- Kontestimi shekullor i vetëvendosjes së Kosovës;
- Pavarësia e Kosovës rivendosje e një të drejtë të mohuar;
- Kosova i plotëson të gjitha kushtet për të qenë shtet sipas standardeve ndërkombëtare;
- Pavarësia e Kosovës ushtrim i vetëvendosjes së popullit me mjete paqësore dhe luftë çlirimtare;
- Ushtrimi i gjenocidit nga shteti serb dhe pavarësia e Kosovës;
- Pavarësia e Kosovës - hapi vendimtar drejt zgjidhjes së konfliktësisë shekullore shqiptaro-serbe;
- Pavarësia e Kosovës storie e suksesit ndërkombëtar;
- Pavarësia e Kosovës - faktor i stabiliteti rajonal dhe me gjerë;
- Pavarësia e Kosovës hap drejt integritimeve kombëtare.



# FALEMINDERIT PËR VËMENDJE!

---

